

SHTYLLA II

ÇËSHTJE PRAKTIKE DHE ADMINISTRATIVE

Kompensimi Civil i Veprave Penale në Shqipëri
Nga Dr. Av. Dorina Ndreka Asllani
Pedagoge, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Ligjore, Universiteti i Durrësit
"Aleksandër Moisiu"

I. ABSTRAKT

Kur shkaktohet dëm, lindin detyrime dhe përgjegjësi ligjore. Ky është një parim shumë i rëndësishëm i legjislacionit civil që shoqëron veprat penale. Kryerja e veprave penale shkel ligjin, por në të njëjtën kohë, cënon dhe dëmton drejtpërsëdrejti viktimat, të cilat kanë të drejtën e kompensimit civil. Kodi i Procedurës Penale në Shqipëri, në nenet 58-68, ka përcaktuar në mënyrë specifike mundësinë e paditësit civil të dëmtuar nga një vepër penale, për të marrë pjesë aktive në procesin penal, duke kërkuar kompensimin e dëmit civil të pësuar. Shfrytëzimi i mundësisë së dhënë nga këto dispozita është një alternativë e mirë për të parandaluar kriminalitetin, sepse në raste të caktuara, pagimi i dëmshpërblimeve civile mund të jetë më efektiv për viktimën, sesa dënimi penal i dhënë nga gjykata. Viktimat e veprës penale pësojnë humbje të ndryshme financiare të tilla si: faturat e spitaleve, humbja e kohës nga puna, çrregullimet mendore ose psikologjike, mallra të dëmtuara ose të vjedhura, shpenzimet e varrimit etj. Shkelësi është i detyruar të paguajë dëmin pronësor, biologjik dhe moral që i ka shkaktuar viktimës. Gjykata është autoriteti kompetent për të vendosur vlerën e kompensimit të dëmit. Studimet e fundit ndërkombëtare në fushën e analizimit të sjelljes së viktimës tregojnë se kompensimi civil i dëmit të shkaktuar nga veprat penale është më i kënaqshëm për viktimat krahasuar me dënimin e tij penal. Në disa raste kompensimi civil është e vetmja mënyrë për të vendosur një person përpara përgjegjësisë për veprat penale, veçanërisht në rastin e të miturve. Duke e pasur parasysh se i mituri nuk ka përgjegjësi penale dhe në Shqipëri kemi mungesa të institucioneve korrektuese për të miturit, e vetmja mënyrë për të ndëshkuar është përmes kompensimit civil të dëmeve. Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale dhe praktikën gjyqësore shqiptare në lidhje me dëmshpërblimin civil gjatë procesit penal, si një mënyrë për të zvogëluar shpenzimet gjyqësore dhe procedurale. Duke pasur parasysh se shumica e padive civile për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga veprat penale bëhet në procese gjyqësore të ndara, artikulli synon të nxjerrë në pah arsyet kryesore të kësaj dukurie dhe sugjeron mënyra më efektive për kompensimin civil të veprave penale.

FJALË KYÇE: *Kompensimi civil, veprat penale, parandalimi i krimit, Shqipëria*

SHKURTIME:

KC	Kodi Civil Shqiptar
KPrC	Kodi i Procedurës Civile të Shqipërisë
KPrP	Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë

II. HYRJE

Në kulturat primitive, viktimat e një krimi e ndëshkonte shkelësin nëpërmjet shpagimit ose hakmarrjes personale. Viktima i shkaktonte shkelësit dëmtime fizike ose dëme materiale dhe merrte atë që donte nga shkelësi, si dëmshpërblimin për kryerjen e krimi.¹ Koncepti i lashtë i kompensimit ose dëmshpërblimit të viktimës në kohën më moderne është përfshirë në legjislacionin civil për shpërblimin e dëmit. Sidoqoftë, gjurmët e konceptit të dëmshpërblimit janë të pranishme në sistemet bashkëkohore të drejtësisë penale.² Ky aspekt i është thelbësor për garantimin e një procesi penal efektiv, i cili përndryshe do të ishte i paplotë dhe i pjesshëm. Drejtësia restauruese është shembulli i parë por jo i vetmi i prirjes së fundit drejt një qasjeje më "emocionalisht inteligjente" ndaj drejtësisë penale.³ Ajo konsiderohet si një strategji efektive për t'iu përgjigjur veprave penale të qëllimshme. Drejtësia restauruese i referohet një procesi kundërpërgjigjeje ndaj krimi, i përqëndruar në korrigjimin e dëmit që u është bërë viktimave, duke i vendosur shkelësit përpara përgjegjësisë për veprimet e tyre në shumë raste duke angazhuar komunitetin në zgjidhjen e konfliktit. Pjesëmarrja e palëve është një pjesë thelbësore e procesit e cila vendos theksin mbi ndërtimin e marrëdhënieve, pajtimin dhe arritjen e marrëveshjes rreth një rezultati të dëshiruar ndërmjet viktimës dhe shkelësit.⁴

Premisa themelore e paradigmës së drejtësisë restauruese është se krimi është një dhunim i njerëzve dhe marrëdhënieve⁵ dhe jo thjesht një shkelje e ligjit. Sistemi i drejtësisë penale duhet t'u ofrojë atyre që janë më të prekur nga krimi (viktimat, shkelësi dhe komuniteti) një mundësi për t'u mbledhur sëbashku, për të diskutuar ngjarjen dhe për t'u përpjekur të arrijnë njëfarë mirëkuptimi mbi atë që duhet të bëhet për të siguruar riparimin e përshtatshëm të dëmit.⁶

Kjo procedurë garanton të drejtën e kompensimit të viktimës, gjë që nuk arrihet gjithmonë përmes procedurës së zakonshme penale. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e shkelësit përgjatë të gjithë procesit të kompensimit civil të viktimës, ndihmon në arritjen e ekuilibrit i cili është shkatërruar nga veprat penale të shkelësit. Zbatimi në të njëjtën kohë i të dy parimeve, përgjegjësisë civile krahas përgjegjësisë penale, do të ndihmojë në parandalimin e krimeve. Është e rëndësishme të theksohet edhe një aspekt thelbësor i drejtësisë restauruese, nevoja që autorët e veprave penale të riparojnë dëmin që kanë shkaktuar, e cila plotësohet në mënyrë specifike nga drejtësia

¹ Drapkin, I., Viano, E., "Victimology: A new focus", Lexington Books, 1975, fq.215.

² Jacob, B. R., 1970, "Reparation or Restitution by the Criminal Offender to His Victim: Applicability of an Ancient Concept in the Modern Correctional Process", Journal of Criminal Law and Criminology, Vol. 61, 1970.

³ Sherman, W.L., "Reason for Emotion: Reinventing Justice with Theories, Innovations, and Research — The American Society of Criminology 2002 Presidential Address" Criminology, 2003, cit. nga: Doak, J. and Taylor, L. (2013) 'Hearing the voices of victims and offenders: the role of emotions in criminal sentencing.', Northern Ireland legal quarterly., 64 (1). fq. 25-46.

⁴ Handbook on Restorative Justice Programmes, Criminal Justice Handbook Series, United Nations Office on Drugs and Crime, Vienna.

⁵ Zehr, H., Gohar, A., 2003, "The little book of restorative justice", Good Books, Intercourse, Pennsylvania, USA

⁶ Latimer, L., Dowden, C., Muise, D., "The effectiveness of Restorative Justice practices: A meta – analysis", The Prison Journal, Vol. 85, Nr. 2, Qershor 2005.

restauruese, duke u dhënë të dyja palëve mundësinë për të realizuar rikthimin në gjendjen e mëparëshme.

Gjatë shekullit të 20-të, dëmshpërblimi i veprave penale lidhej kryesisht me dëmtimin e pronës dhe dëmtimet në shëndet. Fillimisht ato ishin procese të veçanta civile, të cilat kërkonin kohë dhe para dhe shpesh ishte e vështirë tqë proceset të përfundonin në favor të viktimës. Proceset e para lidhur me dëmshpërblimet civile u konsideruan si një mënyrë për të kompensuar viktimën nga humbjet konkrete të pësuar si pasojë e kryerjes së krimit. Studime të mëtejshme treguan se kompensimi si pjesë e drejtësisë restauruese shihet gjithashtu si një formë shpagimi, një mënyrë për të rregulluar edhe dëmin psikologjike të viktimave dhe një përpjekje për t'i bërë ata të ndihen më mirë brenda shoqërisë.⁷

Megjithëse janë realizuar iniciativa të caktuara, si përshtetull legjislacioni që inkurajon pjesëmarrjen e viktimave në procesin penal, i miratuar në shumë shtete, agjencitë e këshillimit të viktimave, kompensimi i viktimave, drejtësia restauruese, përfshirjen e komunitetit vendor dhe deklaratat e ndikimit të krimit mbi viktimat, shumë viktima ende ndihen të lëna pas dore, të pakënaqura, të viktimizuara edhe më tej nga procesi i drejtësisë.⁸

Ka disa mënyra përmes të cilave viktima mund të jetë pjesë e procesit penal dhe drejtësia restauruese është një nga më të përdorurat në vitet e fundit. Disa vende përdorin formën klasike të pjesëmarrjes së viktimës në procedimin penal. Të drejtat e viktimave në procedimin penal ndryshojnë shumë nga një vend në tjetrin. Në disa vende viktimat kanë të drejta të gjera, siç është e drejta për t'u përfaqësuar, e drejta për ndihmë juridike falas ose e drejta për të pyetur dëshmitarët (Ukraina, Gjermania dhe Italia).⁹ Në Shqipëri këto të drejta para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të fundit nuk kanë qenë të mirëpërcaktuara. Qëllimi kryesor i procedimit penal në Shqipëri është të vendosë nëse një person është fajtor apo jo për veprën penale për të cilën është akuzuar. Sipas KPrP, viktima e krimit mund të jetë pjesë e procesit në dy forma. Njëra nga mënyrat është me anë të paraqitjes së ankimit, kur i pandehuri akuzohet për krime për të cilat ankimi nga pala e dëmtuar është e domosdoshme për fillimin e procedimit penal. Mënyra tjetër është duke ngritur padi civile në procesin penal. Në rastin e dytë është prokurori që sjell çështjen penale në gjykatë për dënimin e të pandehurit, nga gjykata. Megjithatë, pala civile, kërkon dëmshpërblimin civil për dëmin e pësuar.

Drejtësia restauruese konsiderohet një mënyrë shumë efektive jo vetëm për shkakse sjell zgjerimin e ndikimit të vendimeve penale, por edhe për shkak se përpiqet të realizojë kompensimin e dëmit civil dhe rivendosjen esituatës në gjendjen financiare që ekzistonte përpara

⁷Për më shumë shiko edhe: Zehr, H., Gohar, A., 2003, "The little book of restorative justice", Good Books, Intercourse, Pennsylvania, USA; Daly, K., 2011, "Conventional and Innovative Justice Responses To Sexual Violence", Australian Centre for Study of Sexual Assault, No.12

⁸ Handbook on Restorative Justice Programmes, Criminal Justice Handbook Series, United Nations Office on Drugs and Crime, Vienna.

⁹ Country Report, "Improving Protection of Victims' Rights: Access to Legal Aid", Research Paper on The Present Legal Framework And Best Practices, Itali, Dhjetor 2013.

se të ndodhte vepra penale. Është e rëndësishme të theksohet se drejtësia restauruese nuk bazohet në parimet e përgjithshme universale, për shkak të qasjes shumë të ndryshme që ka në pjesë të ndryshme të botës ndaj viktimës dhe hapave që duhet të ndërmerren për kompensimin moral dhe ekonomik të tyre. Një përfitim tjetër i drejtpërdrejtë i kompensimit civil lidhet me zvogëlimin e recidivizmit, përsëritjes së veprës penale. Është e rëndësishme të mos përqendrohem vetëm në këtë aspekt, por nuk mund të shpërfilllet ndikimi psikologjik që kompensimi civil ka mbi personin që ka kryer krimin. Gjithsesi, instalimi i një sistemi funksional për kompensimin civil të dëmeve të shkaktuara nga veprat penale, ka nevojë për një sistem gjyqësor i cili funksionon mirë si dhe për institucionet administrative mbështetëse.

III. PADIA CIVILE NË PROCESIN PENAL NË SHQIPËRI

Sipas të drejtës zakonore shqiptare, ose siç quhet ndryshe Kanuni, është e mundur të gjenden elemente të përgjegjësisë civile për veprat penale. Këto elemente nuk formojnë një institut juridik të rregulluar dhe specifik, por janë pjesë e instituteve të tjera tradicionale, si shkelja e nderit, e jetës ose e pronës. Në këto raste, pavarësisht ndëshkimit që i jepej autorit të veprave penale nga komuniteti, i përfaqësuar nga këshilli i pleqve, zakonisht vendosej edhe një gjobë monetare.¹⁰ Legjislacioni aktual shqiptar ka dy institute kryesore që lidhen me kompensimin civil të veprave penale: padinë civile në procesin penal të rregulluar nga Kodi i Procedurave Penale Shqiptare dhe shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, të parashikuara nga Kodi Civil Shqiptar. Këto institucione nuk janë konkurruese, por plotësuese me njëra-tjetrën.

Më 1 gusht 2017 hynë në fuqi ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë.¹¹ Këto ndryshime, të cilat janë pjesë e reformës në drejtësi, përfaqësojnë ndryshimet më thelbësore që nga hyrja në fuqi e këtij Kodi. Neni 58 i është nënshtruar ndryshimeve formale dhe strukturore. Personi i dëmtuar nga vepra penale, tani quhet "viktимë". Ky nen përcakton të drejtat procedurale të viktimës gjatë procedimit penal ku dispozitat më të rëndësishme përfshijnë: të drejtën për të kërkuar marrjen e provave; të drejtën për t'u përfaqësuar nga një avokat dhe nëse plotësohen kërkesat ligjore për të përfituar ndihmë juridike falas; të drejtën për të depozituar një ankesë kundër vendimeve të prokurorisë, etj. Një nga risitë më të rëndësishme të këtij neni të sjellë me ndryshimet e fundit është detyrimi i prokurorisë që të njoftojë viktimën për të gjitha të drejtat e përmendura në këtë nen, dhe të mbajë kopje të shkruar të këtij njoftimi. Parashikimet e kësaj dispozite plotësohen në terma më konkrete nga nenet e mëposhtme të Kodit të Procedurës Penale. Nga neni 61 sipas të cilit: "*Ai që ka pësuar dëm nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.*".

Duke marrë parasysh se ndryshimet e fundit kanë qenë në fuqi vetëm për pak muaj, është shumë shpejt për të vlerësuar ndikimin praktik të nenit 58. Deri më tani, praktika shqiptare e procedimit

¹⁰ "Kanuni i Lekë Dukagjinit", mbledhur nga Shtjefën Gjeçovi, Tiranë, 1989.

¹¹ Ligji Nr. 35/2017, datë 30.03.2017, "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të Ndryshuar.

penal nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur padisë civile në procesin penal. Kjo lidhet me mungesën e njohurive për dispozitat përkatëse të ligjit. Prokurori më parë nuk i informonte viktimat e veprave penale lidhur me hapat procedural dhe fillimin e procedurave gjyqësore. Në shumë raste, vetë gjykata e ndan çështjen penale nga padia civile, gjë që është për të ardhur keq, duke pasur parasysh se pranimi i një padie civile në procesin penal zgjidh shpejt kërkesat e personit të dëmtuar nga vepra penale.¹² Gjithashtu, paraqitja e një padie civile në një çështje penale ka përparësinë kryesore të bashkimit të dy procedurave në një, me shpenzime të reduktuara financiare. Prokurori është përgjegjës për mbledhjen dhe paraqitjen e provave në lidhje me përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Kërkesat civile paraqiten nga avokati i palës civile dhe të gjitha rregullat procedurale duhet të jenë në përputhje me KPrC.

Shpërblimi i dëmit jashtë-kontraktor është një institut i rëndësishëm ji të drejtës civile shqiptare. Praktika gjyqësore lidhur me këtë parim ka evoluar gjatë viteve të fundit. Dëmet e shkaktuara gjatë aksidenteve rrugore kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Disa vjet më parë, vetëm raste të rralla në lidhje me kompensimin për dëmin e pësuar nga aksidentet rrugore, silleshin në gjykatë. Situata është krejtësisht e ndryshme tani, kryesisht për shkak të rritjes së njohurive nga publiku në lidhje me këtë mundësi. Neni 608 i KC-së përcakton: "*Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.*" Sipas KC, nëse dëmin e ka shkaktuar më shumë se një person ata janë përgjegjës solidarisht ndaj palës së dëmtuar.¹³ Megjithatë, është në kompetencë të procesit gjyqësor, qoftë penal apo civil, të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në veprën penale. Padia civile në procesin penal i drejtohet të pandehurit, ose të paditurit civil, kur përgjegjësia civile bie mbi një person të ndryshëm nga ai që ka kryer krimin, si në rastin e të miturve.

Dëmi civil i cili është shkaktuar si pasojë e një veprë kriminale, vazhdon të ekzistojë dhe persona të caktuar kanë të drejtë ta kërkojnë atë, edhe në rastet kur përgjegjësia penale shmanget si rezultat i amnistisë, faljes ose arsyeve të tjera.

IV. PROBLEMET E PADISË CIVILE NË PROCESIN PENAL

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është e vetmja gjykatë e shkallës së parë e cila ka publikuar të gjitha vendimet e saj civile dhe penale në faqen zyrtare të internetit, duke dhënë një ndihmë të madhe për të studiuar praktikën gjyqësore të gjykatave shqiptare.¹⁴ Duke shqyrtuar vendimet penale të gjykatave gjatë viteve të fundit, është e dukshme se paditë civile në procesin penal janë

¹² Mustafaj, I., "Dëmi civil i ardhur nga vepra penale", Morava, Tiranë 2011

¹³ Neni 626 e Kodit Civil: "*Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht.*"

¹⁴ www.gjykatatirana.gov.al

shumë të rralla. Edhe në ato pak raste kur viktimat ose të afërmit e tij kanë depozituar një kërkesë për dëmshpërblim, gjykata rrallëherë e ka pranuar kërkesën.

Analiza e këtyre vendimeve nxjerr në pah disa nga arsyet kryesore për ekzistencën e kësaj situate.

- i. Gjykatat Penale Shqiptare kanë prirjen t'i bien shkurt kërkesës për ngritjen e padisë civile në procesin penal. Duke e konsideruar atë si një barrë për zhvillimin e përgjithshëm të procesit penal, gjyqtarët vendosin të ndajnë padinë civile nga çështja penale. Neni 62 (3) i KPrP-së, përcakton se gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile nga çështja penale në rast se padia civile e komplikon apo e vonon procesin penal. Po të marrim në konsideratë se gjatë procesit penal, gjykata shqyrton elemente të tilla si: faktet, dëshmitë, dëshmitarët, ekspertizën e paraqitur nga prokuroria dhe i pandehuri, është e qartë se ndarja e çështjeve dëmton jo vetëm viktimën, por edhe vetë sistemin ligjor dhe sundimin e ligjit. Për më tepër, sipas nenit 297 (a) të KPrC-së: "*Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur : a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile apo administrative....*" Sipas këtij neni, viktimat e krimit do të duhet të presë përfundimin e procesit penal për të vazhduar me procesin civil. Kjo nënkupton që nëse gjykata e konsideron kërkesën për kompensim civil të arsyeshëm dhe të mbështetur në ligj, do të kalojnë 2 deri në 4 vjet, ndonjëherë edhe më shumë, përpara se të njihet kompensimi civil. Kalimi i një kohe kaq të gjatë dëmton zbatimin e ligjit dhe efektivitetin e drejtësisë.
- ii. Kur një dukuri nuk konsiderohet si vepër penale ose kur i pandehuri shkarkohet nga akuzat, kërkesa civile nuk zgjidhet nga gjykata penale. Në këtë rast kërkesa civile duhet të ngrihet përsëri para gjykatës civile dhe të gjitha procedurat do të fillojnë nga fillimi, që do të thotë se do të jetë kohë dhe një barrë e lartë financiare për viktimën.
- iii. Një nga dallimet kryesore ndërmjet procedurave civile dhe penale ka qenë pamundësia për të kërkuar dëmin moral në çështjen penale, pasi neni 61 i KPrP-së i referohet vetëm dëmit material. Dëmi moral mund të kërkohej vetëm përmes një procesi të veçantë civil. Në shumë raste kërkesa e kompensimit nga viktimat e krimit lidhet me dëmin moral. Kjo është shpesh arsyeja për mos paraqitjen e kërkesës për kompensim në procesin penal. Viktimat mund të mos kenë pësuar dëme materiale, por vetëm ato morale, ose për të provuar ekzistencën e saj mund të jetë aq e vështirë, sa që kërkesa civile do të bëhet e pavlefshme. Nga ana tjetër, procesi civil sjell shpenzime në kohë dhe në para dhe kritikohen për vonesa dhe për vendime të padrejta. Këto ishin arsyet, pse ndryshimet më të fundit në KPrP, kanë hequr këtë kufizim. Tani është e mundur të kërkohej me anë të padisë civile në procesin penal, si dëmi material ashtu dhe ai moral, i shkaktuar viktimës ose trashëgimtarëve të tij / saj.
- iv. Deri më tani, një nga mangësitë kryesore në lidhje me të drejtat e viktimave në procesin penal ka qenë mungesa e informacionit dhe mungesa e detyrimit ligjor të punonjësve të policisë dhe prokurorëve për të informuar viktimat e krimit lidhur me mundësitë e

kompensimit. Është e nevojshme që viktimat të njohin të drejtat e tyre procedurale në kohë, me qëllim që të marrin masat e nevojshme për përpilimin e një padie të vlefshme. Duke pasur këtë parasysh nenin 58 i KPrP-së, tashmë detyron prokurorinë të njoftojë viktimën për të gjithë të drejtat e tij/saj procedurale.

- v. KPrP siguron mundësinë e ndihmës juridike falas për të pandehurit të cilët nuk mund të përballojnë shpenzimet e avokatit. Kjo e drejtë procedurale e deritanishme nuk ishte e garantuar për viktimat e krimeve, pavarësisht faktit se ata janë më të dëmtuarit dhe në shumë raste nuk kanë pasur mjetet e nevojshme për të marrë pjesë në gjykim dhe për të qenë pjesë e procedurave ligjore. Mungesa e ndihmës juridike falas konsiderohet pengesë kryesore për zbatimin e duhur të të drejtave procedurale të viktimës në procedurën penale. Neni 58 (ç) i KPrP-së, tani i jep të drejtën viktimës së krimit për të përfituar ndihmë juridike falas, në rast se nuk ka mjete financiare për ta përballuar atë. Gërma (gj) e të njëjtit nen, siguron të drejtën e viktimës për t'u përjashtuar nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore.
- vi. Një mangësi tjetër e pozicionit procedural të viktimës, në përputhje me dispozitat e mëparshme të KPrP-së, ishte mungesa e të drejtave të mirëpërcaktuara të viktimës në procesin penal. E vetmja mënyrë që viktimat të mund të bëjnë pjesëmarrëse aktive, ishte depozitimi i padisë civile në procesin penal. Edhe në ato raste kur viktimat kishin një përfaqësim ligjor, përfaqësuesi i saj kishte shumë pak të drejta ligjore. Sipas variantit të mëparshëm të nenit 58 të KPrP-së, pala e dëmtuar e veprës penale kishte të drejtë të kërkonte ndjekjen penale të shkelësit, dëmin civil të shkaktuar, të paraqiste kërkesa dhe të kërkonte marrjen e provave. Neni nuk jepte ndonjë specifikim, modalitet apo detaje se si prokuroria do t'i përmbushë këto detyrime. Ndryshimet e fundit, e kanë rregulluar këtë situatë, duke i dhënë viktimës të drejta specifike ligjore të cilat mund të ushtrohen në mënyrë efektive, të cilat përfshijnë ndër të tjera: të drejtën për të kërkuar ndjekjen penale; të drejtën për të kërkuar në çdo kohë informacion në lidhje me statusin e procedimit dhe për t'u njohur me aktet dhe provat e çështjes; të drejtën për të kërkuar marrjen e provave dhe për të paraqitur kërkesa të tjera procedurale; të drejtën për t'u informuar mbi arrestimin dhe lirimin e të akuzuarit; të drejtën për t'u njoftuar për mos-fillimin ose pushimin e procedimit penal ose për fillimin e gjykimit; të drejtën për të apeluar në gjykatë vendimin e mos fillimit ose pushimit të procedimit penal; të drejtën për t'u thirrur në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore; të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, edhe nëse nuk kërkohet si dëshmitar; të drejtën për të ushtruar të drejta të tjera procedurale të ofruara nga KPrP.
- vii. Një risi e dispozitave më të fundit është e drejta e viktimës për të pasur kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet publike; dhe e drejta për të komunikuar në gjuhën e vet me ndihmën e përkthyesit.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ndryshimet e fundit të KPrP-së pasqyrojnë një qëndrim të reformuar ndaj pozitës së viktimës në procesin penal. Të dhënat e mbledhura nga gjykatat shqiptare, të cilat janë bazuar në rregullat e vjetra procedurale, dëshmojnë se numri i padive civile gjatë proceseve penale ka qenë i kufizuar. Përfshirja nga ana e KPrP-së e koncepteve të drejtësisë restauruese, e cila mund të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit të ligjit penal dhe procedimeve penale, pritet që do të nxisë ngritjen e padive civile gjatë proceseve penale. Kjo do t'i inkurajonte palët që të vlerësojnë më mirë pasojat e veprimeve kriminale dhe kompensimin civil përkatës. Sfida e pritshme është interpretimi dhe zbatimi i duhur i dispozitave të reja. Objektivi kryesor duhet të fokusohet jo vetëm në shmangien e dy proceseve të ndara, penale dhe civile, për të njëjtën dukuri, , por edhe në shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar viktimës. Doktrina përmend një sërë arsyes që mbështesin preferencën e paraqitjes së padisë civile për dëme të shkaktuara nga vepra penale përpara gjykatës penale, në vend të paraqitjes së tyre përpara gjykatës civile.¹⁵

Disa nga arsyet kryesore mund të përmbledhen si më poshtë:

- i. Gjyqtari i procedimit penal ka një pamje më të qartë dhe të plotë të ngjarjeve reale, duke pasur mundësinë që të vlerësoj më mirë dhe më saktë masën e dëmeve të shkaktuara;
- ii. Procedimet penale janë më të shpejta dhe më pak të kushtueshme;
- iii. Viktima nuk është e detyruar të paraqesë prova përpara gjykatës pasi kjo është detyrë e prokurorit;
- iv. Vlerësimi i të dy çështjeve në të njëjtin proces shmang vendimet kontradiktore në lidhje me paditë penale dhe civile;
- v. I jep mundësi viktimës ose pasardhësve të saj/tij të jenë të pranishëm gjatë procedimeve penale, që në të kundërt do ishte e pamundur.

Një tjetër element i rëndësishëm në favor të procesit të kompensimit civil gjatë procedimit penal ose edhe si procedurë më vete, lidhet me mundësitë reale të dëmshpërblimit. Legjislacioni dhe aktet nënligjore në Shqipëri garantojnë respektimin e plotë të detyrimeve civile, megjithatë dëmshpërblimi civil për shkak të veprave penale, duhet të ketë parashikime specifike të cilat nuk mund të zbatohen në rastet e zakonshme të mosmarrëveshjeve civile. Disa nga masat që duhet të ndërmerren në këtë drejtim janë:

- i. Krijimi i një fondi special shtetëror për dëmshpërblimin e viktimave të krimit. Jo vetëm Marrëveshjet Ndërkombëtare që kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të viktimave, por edhe legjislacionet e brendshme të disa vendeve sugjerojnë krijimin e një fondi special shtetëror, që do të arrij të dëmshpërblej dhe kompensoj viktimat e krimeve. Ky fond mund të administrohet nga institucione të posaçme, të cilat do të jenë përgjegjëse për paditë e dëmshpërblimit kundër të pandehurit. Kështu, në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore,

¹⁵Për më shumë shiko: Mustafaj, I., "Dëmi civil i ardhur nga vepra penale", Morava, Tiranë 2011; Islami, H., Panda, I., Hoxha, A., 2003 "Procedura penale: komentari", Tiranë, Morava.

Shqipëria ka ngritur institucionin e Koordinatorit Kombëtar, i cili është përgjegjës për ndërtimin e skemës së kompensimit dhe rehabilitimit të viktimave të trafikimit.¹⁶

- ii. Një mundësi e mirë për krijimin e këtij fondi do të ishte përdorimi i pronave të konfiskuara të të akuzuarve apo të dënuarve. Sipas legjislacionit ekzistues, në disa çështje penale, sidomos ato që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, shteti është i autorizuar të konfiskoj pasuritë e të akuzuarve që në fillim të çështjes. Shteti mund të përdorë të gjithë kompetencat e tij për të hetuar pasuritë e të pandehurit. Gjatë procesit civil, gjithashtu ekziston mundësia e konfiskimit apo e sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të të pandehurit; ndërkohë që gjatë procedimit penal mund të konfiskohen të gjitha llojet e pasurisë të cilat konsiderohen si burime të gjeneruara nga aktivitetet kriminale.
- iii. Kompensimin civil mund të realizohet edhe duke ofruar mundësi punësimi për personat që kanë kryer krime, duke u dhënë atyre mundësi reale për të gjeneruar të ardhura të cilat do të përdoren për të paguar dëmshpërblimin civil.
- iv. Dëmshpërblimi civil i viktimës mund të inkurajohet gjithashtu nga gjykata dhe më anë të formulimit të dënimit penal. Një variant pozitiv është zbatimi i modelit gjerman. Që në fillim të procedurave hetimore, ekziston mundësia për të inkurajuar të akuzuarin të kompensojë dëmin shkaktuar viktimës (*neni 153/a/1 Kodi i Procedurës Penale në Gjermani*). Prokuroria mund të pushojë hetimin në rast se arrihet një marrëveshje me të pandehurin sipas të cilës ai do të kryejë disa pagesa në favor të viktimës së krimit në cilësinë e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Nëse i akuzuari nuk i plotëson detyrimet që i janë ngarkuar atij, në emër të viktimës, pezullimi i dënimit revokohet.¹⁷

Kompensimi civil i të dëmtuarve nga veprat penale është me rëndësi për mirëqenien e viktimave, për të shmangur recidivizmin (përsëritjen e krimeve) dhe për t'i siguruar shoqërisë një dimension më njerëzor, të cilin momentalisht shoqëria shqiptare duket se e ka humbur. Siç u argumentua dhe në artikull, mënyra më e mirë është përfshirja e padisë civile të dëmshpërblimit gjatë procesit penal. Reformat legjislative në këtë drejtim janë të pashmangshme, pasi aktualisht edhe pse është ligjërish e mundur paraqitja e padisë civile në procesin penal, në praktikë shanset e ndjekjes me sukses të kësaj procedure janë pothuaj minimale. Është thelbësorë për shoqëritë e dobëta që t'i japin të njëjtën rëndësi mundësisë së dëmshpërblimit të viktimës, siç i japin rëndësi dënimit të shkelësve të ligjit.

¹⁶Raporti i Koordinatorit 2006 thotë: “Skema e dëmshpërblimit dhe rehabilitimi të viktimave të trafikimit, bazohet ndër të tjera dhe në konfiskimin e pasurisë do të ngihet së shpejti. I njëjti angazhim shfaqet dhe në dokumentin zyrtar të qeverisë “Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014-2017”, por as skema as fondi nuk janë krijuar ende.

¹⁷ Löffelmann, M., “The Victim in Criminal Proceedings: A Systematic Portrayal of Victim Protection under German Criminal Procedural Law.” Resource Material Series No.70, International Training Course Visiting Experts’ Papers.